



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGI  
ENERGY REGULATORY OFFICE  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

## CAQET INDIKATIVE TË HUMBJEVE NË OPERATORIN E SISTEMIT TË SHPËRNDARJES

**Prishtinë, dhjetor 2011**

---

Adresa: Rr. Hamdi Mramori nr. 1, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: 038 247 615 lok.. 101, Fax: 038 247 620, E-mail: [info@ero-ks.org](mailto:info@ero-ks.org), web: [www.ero-ks.org](http://www.ero-ks.org)



## 1 Hyrje

Sipas Rregullës për vendosjen e çmimeve të Operatorit të sistemit të shpërndarjes ("Rregulla e Çmimeve të OSSH-së"), OSSH-ja do të jetë përgjegjëse, si tani, për blerjen e energjisë për të mbuluar humbjet e shpërndarjes. Kjo do të bëhet si më poshtë:

- OSSH-ja do të marrë një nivel të lejuar të humbjeve, kostot e të cilave mbulohen përmes ngarkesave të saj të shfrytëzimit të sistemit të shpërndarjes (DUOS). Niveli i lejuar i humbjeve llogaritet si produkt i përqindjes së humbjeve të lejuara, vëllimeve të energjisë elektrike që hynë në Sistemin e shpërndarjes dhe çmimit mesatar me shumicë.
- OSSH-ja paguan furnizuesit për humbjet e realizuara. Shuma e paguar llogaritet si produkt i humbjeve të realizuara të shpërndarjes (e shprehur si përqindje), vëllimit të energjisë elektrike që hynë në sistemin e shpërndarjes dhe çmimit mesatar me shumicë.
- Diferenca midis nivelit të lejuar të humbjeve dhe humbjeve të realizuara ndahet në mes të OSSH-së dhe shfrytëzuesve të sistemit të shpërndarjes (përmes përshtatjes së të hyrave të lejuara në vitet pasuese). Nëse humbjet e realizuara (në përqindje) janë nën humbjet e lejuara (edhe këto në përqindje), atëherë të hyrat nga niveli i lejuar i humbjeve do të tejkalojë kostot e realizuara të humbjeve dhe OSSH-ja do të mbajë pjesë të tepricës (ose pjesë të deficitit nëse humbjet e realizuara janë nën humbjet e lejuara). Pjesa tjetër u kthehet përdoruesve. Pjesa e humbjeve që mbahet nga OSSH-ja përkufizohet nga Faktori ndarës i humbjeve. Kjo ndarje ofron nxitje për OSSH-në që të zvogëlojë humbjet meqë mban pjesë të fitimit nga reduktimi i humbjeve të realizuara nën nivelin e lejuar.

Për caktimin e kontrollit të çmimeve për OSSH-në, ZRRE-ja ka nevojë të përcaktojë vlerat e:

- Përqindjes së humbjeve të lejuara që përdoret në llogaritjen e nivelit të lejuar të humbjeve.
- Faktorit ndarës të humbjeve i cili përcakton se çfarë pjese e tepricës ose deficitit të nivelit të lejuar të humbjeve mbi humbjet e realizuara mbahet nga OSSH-ja.

Ky dokument paraqet caqet indikative të nivelit të përqindjes së humbjeve të lejuara në OSSH. Vlerat e realizuara që do të aplikohen në kuadër të secilit kontroll të çmimeve do të përcaktohen në shqyrtimet individuale të çmimeve dhe për to do të mbahen konsultime në kuadër të procesit të shqyrtimit.



## **2 Përcaktimi i përqindjes së humbjeve të lejuara**

ZRRE-ja synon të vendosë përqindjet e humbjeve të lejuara bazuar në caqet indikative të përcaktuara nga bordi i ZRRE. Sipas Rregullës së Çmimeve të OSSH-së, periudha e shqyrtimi kalimtar të çmimit do të zgjasë për një vit dhe kontrollet pasuese për pesë vite. Prandaj, ZRRE-ja do të vendosë përqindjen e humbjeve për një vit sipas kontrollit kalimtar dhe në kontrollet tjera pasuese për periudha pesë-vjeçare.

Vlera bazë fillestare do të përcaktohet duke iu referuar humbjeve të realizuara në kohën e shqyrtimit të çmimeve. Reduktimi vjetor do të përcaktohet duke iu referuar performancës së kaluar në Kosovë, normave të reduktimit të arritur apo të lejuar nga rregullatorët në vendet me karakteristika të ngjashme me Kosovën dhe nivelet e humbjeve totale të shpërndarjes në vende të ngjashme.



### 3 Nivelet aktuale të humbjeve

Humbjet në OSSH llogariten si diferenca midis energjisë së matur që hynë në sistemin e shpërndarjes dhe energjisë së matur që del nga sistemi në njehsorët e konsumatorëve (faturimin).

Këto humbje përbëhen nga humbjet teknike, furnizimet e pafaturuara për zonat e pakicave dhe humbjet komerciale (kryesisht vjedhje)<sup>1</sup>. Niveli i humbjeve teknike vlerësohet duke përdorur modele të rrjetit. Niveli i humbjeve komerciale pastaj llogaritet si humbjet totale në OSSH minus humbjet teknike.

Në shqyrtimin e saj më të fundit të çmimeve<sup>2</sup>, ZRRE-ja ka lejuar humbje totale të shpërndarjes prej 37.1%, nga të cilat 17.1% konsiderohen të jenë humbje teknike dhe 20.0% humbje komerciale. Rishikimi më i fundit i jashtëm i humbjeve të shpërndarjes është zhvilluar në fillim të vitit 2011 nga Advanced Engineering Associates Limited (AEAI) me financimin e USAID-it. Rishikimi ka verifikuar humbjet e raportuara nga KEK-u dhe ka konkluduar se metodologjitë e përdorura për vlerësimin e humbjeve teknike janë esencialisht solide. Humbjet në OSSH të vitit 2010 siç janë raportuar në studimin e AEAI-së tregohen më poshtë<sup>3</sup>.

**Figura 1: Humbjet aktuale të OSSH**

	SHTE5 e lejuar	Të raportuara nga KEK	Studimi i AEAI
Humbjet teknike	17.1%	17.20%	16.8%
Humbjet komerciale	20.0%	24.02%	20.3%
Furnizimet e pafaturuara për minoritetet	-	-	4.1%
<b>Totali</b>	<b>37.1%</b>	<b>41.2%</b>	<b>41.2%</b>

<sup>1</sup> ZRRE përkufizon energjinë që matet dhe faturohet por që nuk paguhet në kuadër të humbjeve të arkëtimit apo borxheve të këqija. Këto nuk përbëjnë lëndë të këtij raporti.

<sup>2</sup> Shqyrtimi i pestë i tarifave të energjisë elektrike (SHTE5) për tarifën që hyjnë në fuqi nga 1 prilli 2011.

<sup>3</sup> Studimi i AEAI-së llogarit përqindjet e humbjeve si humbjet pjesëtuar me të gjithë energjinë që hyn në sistemin e shpërndarjes duke përfshirë atë për përdorim të brendshëm nga KEK-u. ZRRE-ja, në përcaktimin e të hyrave të lejuara, llogarit përqindjet e humbjeve si humbjet pjesëtuar me energjinë që hyn në sistemin e shpërndarjes minus energjia e konsumuar së brendshmi, pasi kjo shmang shtrembërimet në krahasimet nga viti në vit të humbjeve të shkaktuara nga ndryshimi i niveleve të përdorimit të brendshëm. Përqindjet e humbjeve të paraqitura në këtë raport llogariten duke ndjekur qasjen e ZRRE-së.



Në SHTE5 caku i nivelit të humbjeve që ishte aprovuar nga ZRRE-ja për humbjet komerciale ishte 20 %, duke përfshirë furnizimin e pafaturuar në zonat e minoriteteve.

### 3.1 Humbjet e energjisë elektrike në OSSH

Humbjet e energjisë elektrike të raportuara nga KEK-u paraqiten më poshtë.

**Figura 2: Humbjet e energjisë elektrike në OSSH për vitet 2006-2010**

	2006	2007	2008	2009	2010
Humbjet teknike	18.15%	17.42%	17.05%	18.05%	17.20%
Humbjet komerciale	30.21%	30.68%	25.76%	24.76%	24.02%
<b>Totali</b>	<b>48.37%</b>	<b>48.10%</b>	<b>42.82%</b>	<b>42.80%</b>	<b>41.22%</b>

Humbjet e KEK-ut kanë pësuar rënie prej rreth 7% gjatë periudhës pesë-vjeçare.

### 3.2 Humbjet e energjisë në OSSH të vendeve në rajon

Shifrat e humbjeve në mesin e tregjeve të krahasueshme të energjisë elektrike në rajon janë marrë nga raportet e rregullatorëve përkatës të energjisë. Këto tregohen më poshtë.

**Figura 3: Humbjet e energjisë sipas OSSH**

	Shqipëria	Kroacia	Maqedonia	Moldavia	Rumania	Serbia
2006	41.0%	8.3%	n/a	18.4%	n/a	14.2%
2007	36.4%	9.8%	28.2%	17.3%	n/a	14.2%
2008	34.0%	7.2%	25.0%	16.3%	12.1%	14.5%
2009	35.3%	n/a	n/a	n/a	12.9%	15.2%

Burimi: Raportet e rregullatorëve dhe EPS (Serbia)

Edhe pse të dhënat e fundit nga raportet e rregullatorëve nuk janë në dispozicion, humbjet e Kosovës janë dukshëm të larta krahasuar me standardet rajonale, madje edhe kur krahasohen me vendet që kanë vuajtur nga rrjete në gjendje ngjashëm të dobët të tilla si Bosnje-Hercegovina dhe Serbia. Është gjithashtu e dukshme se këto vende të krahasuara që kanë pasur nivelet më të larta të humbjeve kanë qenë në gjendje të arrijnë reduktime relativisht të shpejta me rreth 2% në vit në Shqipëri dhe 3% në Maqedoni (edhe pse kjo bazohet në reduktimin e vetëm një viti).



## 4 Caqet indikative të humbjeve të lejuara

Duke bërë vlerësimin e këtyre komenteve është konstatuar se palët e interesit kanë shfaqur brengën e tyre se rrethanat kosovare janë në veçanti sfiduese në lidhje me ato të vendeve tjera në rajon dhe se kjo mund të shpie drejt shkallëve më të ngadalshme të reduktimit të humbjes. Ndërsa, ZRRE konsideron se Kosova nuk është aq e ndryshme sa sugjerojnë palët e interesit, dhe vëren se janë dhëne dëshmi të kufizuara për t'i arsyetuar pohimet e tyre. ZRRE pranon se duhet pasur kujdes kur bëhen krahasime të tilla rajonale.

ZRRE ka parasysh faktin se humbjet e përgjithshme janë në nivel të lartë dhe janë të arritshme caqet indikative të paraqitura në vijim për:

- Vitet 1 deri 3 reduktim të humbjeve në OSSH 3%;
- Vitet 4 deri në 6 reduktim të humbjeve në OSSH 2.5%.

Vlerat ekzistuese do të caktohen gjatë kohës të rishikimit të tarifës duke i marrë parasysh vendimet për shpenzime kapitale që do të përfshihen në të hyrat e lejuara të OSSH-së.

Faktori për ndarjen e humbjes prej 50% do të aplikohet. OSSH-ja mund të propozoj një faktor për ndarjen e humbjes i cili ndan një pjesë më të madhe të performancës për OSSH-në, por do të pritej të propozoheshin objektiva më sfiduese për reduktimin e humbjeve krahasuar me nivelin e përcaktuar, bazuar në faktorin ndarës prej 50%.

Këto që u thanë më lartë janë të paraqitura në tabelën me poshtë.

**Figura 4: Caqet indikative të reduktimit të humbjeve të energjisë elektrike**

Caqet indikative të reduktimit të humbjeve të energjisë elektrike	
Viti	Pikë përqindjeje
2012	3.0
2013	3.0
2014	3.0
2015	2.5
2016	2.5
2017	2.5
<b>Gjithsejt</b>	<b>16.5</b>

Niveli i përcaktuar i caqeve indikative bazohet në planin e miratuar të investimeve për OSSH dhe ndryshimi i vlerës së investimeve do të reflektohet në caqet indikative të humbjes në OSSH.